



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	29.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHINA	3805/2022		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.149/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesionale, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1012/2019 të datës 16.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.149/2019 të datës 28.02.2019 e parashtruar nga ankuesja [Blank] e përfaqësuar nga Avokatja [Blank] kundër vendimit me numër 1/2019 të datës 23.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.149/2019 të datës 28.02.2019, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Presidenti i Republikës së Kosovës, me dekretin me numër DED-014-2016 të datës 19.08.2016 ka emëruar ankuesen [Blank] Ambasadore e Republikës së Kosovës në Itali, ndërsa Presidenti i Republikës së Kosovës me datë 23.11.2018 me dekretin me numër DTD-016-2018 urdhëron tërheqjen nga Misioni Diplomatik të ankueses [Blank] Ambasadore/Shefe e Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën e Italisë.

Ankuesja [Blank] e pa kënaqur me Dekretin me numër DTD-016-2018 të datës 23.11.2018 për tërheqjen nga Misioni Diplomatik, ankuesja me datë 24.12.2018 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me datë 23.01.2019 merr vendimin me numër 01/2019 me të cilin vendim refuzohet si e pa lejuar ankesa e ankueses e datës 24.12.2018.

Ankuesja nëpërmjet përfaqësues se saj Avokate e pa kënaqur me vendimin e datës 23.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme me datë 25.02.2019 parashtron ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 28.02.2019 me numër të protokollit 1063/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 16.04.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1012/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.04.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 28.02.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.06.2022 me numër të protokollit 3616/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1012/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar tek organi i punësimit Ministria e Punëve të Jashtme. Ministria e Punëve të Jashtme, me datë 08.03.2019 ka kthyer përgjigje në ankesën e ankueses me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/2.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 28.02.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 23.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të ministrisë së Punëve të Jashtme; Ankesa e ankueses e datës 24.12.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Autorizimi i Avokates i datës 01.12.2018; Dekreti i datës 23.11.2018 me numër DTD-016-2018; Dekreti DED-014-2016 i datës 19.08.2016; e-mail i datës 28.01.2019 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj ankese, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimit respektivisht Dekretin me numër DED-014-2016 të Presidentit të Republikës se Kosovës te datës të datës 19.08.2016 me te cilin ankuesja Alma Lame është emëruar „Ambasadore e Republikës së Kosovës” në



Itali, ka konstatuar se Kolegji për shqyrtimin edhe vendosjen e ankesave i Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *nuk është kompetent* për shqyrtimin e kësaj ankese, pasi që ankuesja nuk e ka statusin e nëpunëses civil në bazë të nenit 4 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka përcaktuar se: *Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme:... të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga Kabineti i Presidentit,...Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale”,* sepse ne rastin konkret krijimi i marrëdhënies së punës se ankueses është bere në bazë të emërimit të datës 19.08.2016 sipas dekretit me numër Nr.DED-014-2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës ashtu siç parashihet edhe me nenin 7 paragrafin 7.1 dhe 7.8 të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ku thotë se : „ 7.1 Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret”, „7.8. Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që pas pranimit të këtij Vendimi, pala ankuese ka të drejtë që të realizoj të drejtën e ankimimit në pajtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat e akteve ligjore, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategoritë e nëpunësve të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi civil, në veçanti me dispozitat e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-212 për Punë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas shqyrtimit të lëndës, dhe bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.149/2019.

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

